



UDHËZIME PËR VOTUESIT

Të nderuar votues të UART (personel akademik dhe studentë), Ju kujtojmë se:

- Zgjedhjet për Autoritetet dhe Organet Drejtuese në UART zhvillohen ditën e mërkurë, dt. 20/04/2016.
- Në UART votohet në tri qendra Votimi: në Fakultetin e Arteve të Bukura (FAB), në Fakultetin e Artit Skenik (FAS) dhe në Fakultetin e Muzikës (FM).
- Qendra e votimit në FAB ndodhet te Lektoriumi (në katin e dytë).
- Qendra e votimit në FAS ndodhet te holli I fakultetit (në katin e parë).
- Qendra e votimit në FM ndodhet te salla "Çesk Zadeja" (në katin e tretë).
- Qendrat e votimit janë të hapura prej orës 08:00 deri në orën 16:00.

▪ **Të gjithë votuesit duhet të jenë të pajisur me kartë identiteti ose pasaportë biometrike të vlefshme. Në rast të kundërt humbasin të drejtën për të votuar!!!**

- Për të lehtësuar procesin, jeni të lutur të gjeni numrin tuaj rendor në listat e afishuara në hyrjen e qendrës së votimit (lista e personelit akademik dhe lista e studentëve).
- **Vota është e fshehtë; ajo plotësohet vetëm në dhomat e fshehta, në rast të kundërt quhet e pavlefshme!!!**
- Mund të votoni duke vendosur shenjat **X** ose **+** në kutinë në krah të kandidatit që doni të zgjidhet. Shenja duhet të vendoset brenda kutisë.
- Kur votohet për Senatin Akademik (nga personeli akademik) në Fakultetin e Artit Skenik dhe Fakultetin e Muzikës mund të votoni jo më shumë se 5 (pesë) kandidatë. Në Fakultetin e Arteve të Bukura mund të votoni jo më shumë se 6 (gjashtë) kandidatë.
- Fletët e votimit, para se të hidhen në kuti, palosen në mënyrë që vulat të ngelen nga jashtë.
- Jini të vëmendshëm për instruksionet që ju japin anëtarët e KZF-ve gjatë procesit.

Në qendrën e votimit nuk lejohet:

- Të bëhet propagandë apo fushatë pro apo kundër kandidatëve.
- Të qëndrojnë persona që nuk janë votues apo të pa autorizuar nga KIZ - UART.
- Të përdoren mjete digjitale për të fotografuar votën (celularë, aparate fotografike apo çdo mjet tjetër me funksion fotografimi).

KIZ -UART